




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.618/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “EJONA”sh.p.k- Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik “Rima Engineering grup 2004 L.L.C.; Rima Engineering sh.p.k” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Vendosja, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit 616-20-2517-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë, më datën: 14.10.2020, mori këtë:

## V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “EJONA” sh.p.k- Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Vendosja, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit: 616-20-2517-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Vendosja, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit 616-20-2517-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “EJONA”sh.p.k- Pejë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “EJONA” sh.p.k- Pejë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 31.08.2020 me nr. 618/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit 616-20-2517-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 65, 68 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe B57 Rregulla për tenderë Jo- Normalisht të ulët.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt. 11.09.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

**Pretendimi nr.1**, Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues është njoftuar me letër standarde si tenderues i pasuksesshëm dhe në ankesën e tij të dorëzuar në OSHP ka pretendime lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë për të cilat eksperti shqyrtues jep këto sqarime.

OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, ku AK-ja tek kapaciteti mbi gjendjen ekonomike dhe financiare ka kërkuar qarkullim financiar në vlerë prej 400,000.00€ dhe as kapacitetin teknik profesional, ku janë kërkuar referenca në vlerë 300,000.00€, për tri vitet e fundit.

Lidhur me këtë pretendim ku OE ankues e argumenton se me vetë faktin se ky operator ekonomik është themeluar në janar të vitit 2020 nuk i plotëson as 1% të kërkesave të dosjes së tenderit dhe njëherit pretendon se, citat: “Ne iu rikujtojmë se ne të gjitha aktivitetet e prokurimit aplikohet kushti ku ne rast të konzorciumit, lideri duhet të mbulojë së paku 60% të kërkesave të DT”.

Eksperti shqyrtues pretendimin e lartshënuar e vlerëson si të paqëndrueshëm për faktin se AK-ja, nuk ka kërkuar që lideri të mbulojë së paku 60% të kërkesave të dosjes së tenderit, siç pretendon OE ankues dhe njëherit sqarohet se kjo kërkesë e OE ankues është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së, ku thuhet: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe



procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë **kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi/referenca për punë të ngjashme dhe në CV-it e stafit (Inxhinierit të Elektroteknikës dhe të Makinerisë), nuk thuhet se kanë përvojë në lëminë e ashensorëve. Eksperti shqyrtues, sqaron se në CV-in e inxhinierëve të lartpërmendur është dhënë eksperiencia si inxhinierë të fushave përkatëse, por për të njëjtit nuk ka referenca për punë në lëmin e kërkuar, si dëshmi e kërkuar në dosje të tenderit. Prandaj, në bazë të dëshmive të ofruara AK-ja, është dashur të verifikoj më në detaje përvojën e inxhinierëve të lartpërmendur, konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari për kontratë për ekipet e teknikeve, nuk ka dorëzuar: CV-in, Diplomën, kontratat e punës ose marrëveshjen për angazhim në këtë projekt.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij e ka ofruar vetëm listën e stafit të ndarë në ekipe në të cilën ka shënuar emrat e stafit, pozitën dhe profesionin dhe për të njëjtit ka dhënë një deklaratë me shkrim se të njëjtit e kanë përvojën e nevojshme. Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në dëshmitë e cekura më lartë, vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar në tërësi kërkesën për 3 ekipet e kërkuara, prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se mbi bazën e listës së stafit të dorëzuar duhet të kërkojë sqarime konform nenit 72 të LPP-së për dëshmitë të cilat mungojnë. Pretendimi i OE ankues lidhur me 3 ekipet teknike të kërkuara në dosje të tenderit është i qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari për kontratë ka ofruar çmime Jo/Normalisht të ulëta, dhe si provë ka ofruar një tabelë të nxjerr sipas kalkulimit që jepet në formularin B57 – Rregullat për tenderët Jo/Normalisht të ulët.

Eksperti shqyrtues e vlerëson si të paqëndrueshëm këtë pretendim për faktin sipas tabelës/formulës së paraparë në formularin B57, nuk llogariten çmimet për njësi por totali i ofertave, që në rastin konkret pragu për tu konsideruar ofertë me çmim Jo/Normalisht të ulët është 128,497.69€ dhe njëherit sipas dispozitave të nenit 61 të LPP-së, vlerësimi i çmimit është e drejtë e autoritetit kontraktues.

Sqarim: Nuk llogariten oferta e cila është shpallur e papërgjegjshme nga AK-ja, që në rastin konkret OE ankues e ka llogaritur edhe ofertën e OE Hymeri i cili është i papërgjegjshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues nuk ka përgjigje.

Operatori Ekonomik me datë 11.09.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje te nderuar,

Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit dhe kërkojmë mbajtjen e seancës në praninë tonë. Kjo pasi që eksperti shqyrtues nuk ka marrë fare për bazë dëshmitë e ofruara nga ne. OE të cilit i është dhënë kontrata, nuk ka as kapacitetin ekonomik dhe as atë teknik e profesional për realizimin e një projekti kaq të rëndësishëm për Komunën e Prishtinës. Andaj, po e përsërisim se dhënia e kontratës këtij Operatori Ekonomik, i cili ka ofruar çmime jashtëzakonisht të ulëta për pozicionet më të rëndësishme në projekt është e jashtëligjshme sepse ky OE e ka të pamundur furnizimin e këtyre produkteve me çmimet që i ka dhënë. Përveç, nëse ky tender është i përgatitur pikërisht për këtë OE dhe kanë marrëveshje interne mes vete me AK "Komuna e Prishtinës". Ne kërkojmë nga OSHP që ta shqyrtoj kërkesën tonë dhe dëshmitë tona, po ashtu ti marrin parasysh edhe çmimet e ofertuesve tjerë si dhe të tregut. Sepse ky mendim i ekspertit është i pa pranueshëm nga ne.

Çdo te mire dhe pune te mbare,

EJONA

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën 14.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EJONA" sh.p.k- Pejë, se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, ku AK-ja tek kapaciteti mbi gjendjen ekonomike dhe financiare ka kërkuar qarkullim financiar në vlerë prej 400,000.00€ dhe as kapacitetin teknik profesional, ku janë kërkuar referenca në vlerë 300,000.00€, për tri vitet e fundit. Më tej, OE ankues shton se me vetë faktin se ky operator ekonomik është themeluar në janar të vitit 2020 nuk i plotëson as 1% të kërkesave të dosjes së tenderit dhe njëherit pretendon se në të gjitha aktivitetet e prokurimit aplikohet kushti, ku në rast të konzorciumit, lideri duhet ti mbuloj së paku 60% të kërkesave të dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar për faktin se



AK nuk ka kërkuar që lideri ti mbuloj së paku 60% të kërkesave të dosjes së tenderit, siç pretendon OE ankues. Gjithashtu, kjo kërkesë e OE ankues është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së, ku thuhet: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “EJONA”sh.p.k- Pejë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi/referenca për punë të ngjashme dhe në CV-it e stafit (Inxhinierit të Elektroteknikës dhe të Makinerisë), nuk thuhet se kanë përvojë në lëminë e ashensorëve. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në CV-in e inxhinierëve të lartpërmendur është dhënë eksperiencia si inxhinierë të fushave përkatëse, por për të njëjtit nuk ka referenca për punë në lëminë e kërkuar, si dëshmi e kërkuar në dosje të tenderit. Prandaj, në bazë të dëshmive të ofruara, AK është dashur të verifikoj më në detaje përvojën e inxhinierëve të lartpërmendur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të OE ankues “EJONA”sh.p.k- Pejë se OE i rekomanduar për kontratë për ekipet e teknikeve, nuk ka dorëzuar: CV-in, Diplomën, kontratat e punës ose marrëveshjen për angazhim në këtë projekt.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij e ka ofruar vetëm listën e stafit të ndarë në ekipe në të cilën ka shënuar emrat e stafit, pozitën dhe profesionin dhe për të njëjtit ka dhënë një deklaratë me shkrim se të njëjtit e kanë përvojën e nevojshme. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar në tërësi kërkesën për 3 ekipet e kërkuara. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se mbi bazën e listës së stafit të dorëzuar duhet të kërkojë sqarime konform nenit 72 të LPP-së për dëshmitë të cilat mungojnë. Pra, pretendimi i OE ankues lidhur me 3 ekipet teknike të kërkuara në dosje të tenderit është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime Jo/Normalisht të ulëta, dhe si provë ka ofruar një tabelë të nxjerr sipas kalkulimit që jepet në formularin B57 – Rregullat për tenderët Jo/Normalisht të ulët.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues e vlerëson si të pa bazuar këtë pretendim për faktin se sipas tabelës/formulës së paraparë në formularin B57, nuk llogariten çmimet për njësi por totali i ofertave, që në rastin konkret pragu për tu konsideruar ofertë me çmim Jo/Normalisht të ulët është 128,497.69€ dhe njëherit sipas dispozitave të nenit 61 të LPP-së, vlerësimi i çmimit është e drejtë e autoritetit kontraktues. Po ashtu, nuk llogariten ofertat të cilat shpallen si të papërgjegjshme nga AK-ja, që në rastin konkret OE ankues e ka

llogaritur edhe ofertën e OE Hymeri i cili është i papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që me rastin e rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së lidhur me përvojën e inxhinierëve dhe listës së stafit të dorëzuar për tri ekipet për dëshmitë të cilat mungojnë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK KK Prishtinë

1x1 OE "EJONA" sh.p.k - Pejë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.